

Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Sportit dhe Rinisë / Ministarstvo Sporta i Omladine / Ministry of Sport and Youth

Prishtinë, Prill 2026

THIRRJE PUBLIKE

Për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës për vitin 2026

Në bazë të Rregullores nr. 36/2024 për procedurat dhe kushtet e financimit të organizatave sportive, Kapitulli III – Financimi për funksionim dhe realizimin e objektivave strategjike, Neni 19 – Aplikimi për financim për funksionimin dhe realizimin e objektivave strategjike, Ministria e Sportit dhe Rinisë (MSR) shpall thirrje publike për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare ne Kosove nga Federatat Sportive.

Ministria e Sportit dhe Rinisë, për vitin 2026, synon avancimin dhe promovimin ndërkombëtar të sportit të Republikës së Kosovës, përmes fuqizimit të kapaciteteve organizative dhe rritjes së cilësisë së organizimit të ngjarjeve sportive në vend.

Në funksion të zhvillimit të diplomacisë sportive dhe rritjes së prezencës ndërkombëtare, MSR, përmes kësaj thirrjeje publike, parasheh të mbështesë federatat sportive, të cilat kanë siguruar konfirmim zyrtar nga federatat përkatëse ndërkombëtare për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës.

QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është të mbështesë financiarisht Federatat Sportive në organizimin e aktiviteteve sportive ndërkombëtare qe zhvillohen në Republikën e Kosovës, në përputhje me objektivat e Strategjisë Shtetërore për Sport 2025–2030, me synim:

- rritjen e prezencës ndërkombëtare të sportit në Kosovë;
- zhvillimin e diplomacisë sportive dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare sportive;
- ngritjen e kapaciteteve organizative dhe profesionale të federatave sportive;
- përmirësimin e standardeve të organizimit të ngjarjeve sportive në përputhje me praktikat ndërkombëtare;
- gjenerimin e ndikimit ekonomik dhe promovues për vendin përmes organizimit të ngjarjeve sportive ndërkombëtare;
- mbështetjen e aktiviteteve që kontribuojnë në realizimin e objektivave strategjike për zhvillimin e sportit në nivel kombëtar.

Kriteret e përgjithshme:

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret në vijim, të cilat sigurojnë përputhshmërinë me kornizën ligjore në fuqi, garantimin e kapaciteteve për realizimin e aktiviteteve nderkombetare qe zhvillohen në Republiken e Kosoves. Plotësimi i këtyre kritereve është kusht i domosdoshëm për shqyrtimin e aplikimit dhe përfitimin e mbështetjes financiare nga Ministria e Sportit dhe Rinisë (MSR).

Vetëm aplikantët që dëshmojnë përmbushjen e plotë të kritereve të përgjithshme do të kalojnë në fazën e vlerësimit të mëtejmë, në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin përkatës dhe aktet nënligjore në fuqi.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Federatat sportive të jenë të licencuara nga MSR;
- Të kenë konfirmim zyrtar nga Federata Ndërkombëtare përkatëse për organizimin e aktiviteteve; jo më vonë se 31 janar 2026;

- Të dëshmojnë kapacitete organizative dhe përvojë relevante;
- Të kenë të përmbyllura te gjitha projektet e përfituara nga MSR gjate viteve paraprake.

PRIORITET NË VLERËSIM

Në kuadër të procesit të vlerësimit të aplikimeve, Komisioni ne kuader te Ministrisë se Sportit dhe Rinisë (MSR) do të aplikojë parimin e përparësisë për projektet që demonstrojnë ndikim më të lartë në zhvillimin e sportit, promovimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe përdorimin efikas, transparent dhe të justifikuar të mjeteve publike.

Projektet do të vlerësohen në mënyrë krahasuese, duke marrë parasysh cilësinë e organizimit, relevancën strategjike dhe efektin e pritshëm afatshkurtër dhe afatgjatë. Në këtë drejtim, përparësi do të kenë projektet që:

Paraqesin ndikim te matshem permes indikatorve konkret, si numri i pjesmarresve nderkombetar, kohen e qendrimit,

- Kanë ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik
- Tërheqin pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare;
- Promovojnë imazhin e Republikës së Kosovës;
- Kontribuojnë në zhvillimin e të rinjve dhe talenteve sportive;
- Kanë plan financiar të qëndrueshëm;
- Promovojnë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale;
- Janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

Dokumente administrative:

- Formulari A – Informatat e përgjithshme;
- Formulari B – Përshkrimi i aktivitetit;
- Formulari i Buxhetit
- Formular standard-Buxheti, Pershkrimi,arsyetimi,planifikimi.
- Konfirmimi nga Federata Ndërkombëtare.

Dokumente përmbajtjesore:

- Përshkrimi i plotë i aktivitetit;
- Plani operacional;
- Plani financiar i detajuar;
- Plani i aktiviteteve;
- Analiza e ndikimit ekonomik dhe social;
- Plani i menaxhimit të rrezikut dhe sigurisë.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara me këtë thirrje publike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike.

Afati i fundit për aplikim është me data 24 Prill 2026.

Aplikimi bëhet në mënyrë fizike në zyrën e arkivit të MSR dhe i njëjti aplikim dërgohet ne email: *behar.hyseni@rks-gov*

SHKALLA E MBËSHTETJES

Shuma totale e mbështetjes për këtë thirrje publike është deri në 2,000,000.00 Euro

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- Komisioni ne kuadër të MSR-së mund të kërkojë sqarime shtesë gjatë procesit të vlerësimit të aplikimeve;
- Vetëm aplikimet e plota dhe të dorëzuara brenda afatit shqyrtohen;
- Vendimet merren në përputhje me buxhetin dhe prioritetet strategjike;

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: behar.hyseni@rks-gov.net

Informacionet mund të kërkohen me shkrim më së fundi pesë (5) ditë para mbylljes së thirrjes publike.

Ministria e Sportit dhe Rinisë
Republika e Kosovës